

Raiffeisen INVEST Sh.a.

Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë
Teatri i Kukullave

Nr. 938 Prot

Nr. 20/2 Prot

KONTRATË SPONSORIZIMI

E lidhur në Tiranë, sot më 08.03.21, midis palëve:

SPONSORIZUES: Raiffeisen INVEST sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe SIK, regjistruar me vendimin nr. 33825, datë 18.07.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, NIPT K51928001I, me seli në adresën Bulevardi "Bajram Curri", ETC, kati 9, Tiranë, përfaqësuar nga Znj. Edlira Konini Administratore e Përgjithshme dhe Znj. Alketa Emini Zv.Administratore e Përgjithshme,

PËRFITUES: Përfituesi Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë-Teatri i Kukullave me adresë: Adresa: Sheshi "Austria", përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor Agim Bajko, Drejtor i Përgjithshëm.

BAZA LIGJORE Kodi Civil i RSH nenet 659-704. Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994, "Për sponsorizimet", i ndryshuar.

Meqenëse ekzistojnë kushtet paraprake si vijon:

- Raiffeisen Invest sh.a shpreh dëshirën të sponsorizojë "Projektet artistike që Teatri i Kukullave do të realizojë gjatë vitit 2021/Dy Premiera teatrale me kukulla"
- Përfituesi Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë-Teatri i Kukullave merr përsipër realizimin dhe zbatimin e kushteve të kësaj kontrate,
- Është përpiluar preventivi i buxhetit bashkëlidhur kësaj kontrate annex 1

Palët bien dakord për sa më poshtë vijon :

Neni 1 QËLLIMI I SPONSORIZIMIT

1.1 Ky sponsorizim kryhet me qëllim realizimin e "Projekteve artistike që Teatri i Kukullave do të realizojë gjatë vitit 2021/ Dy Premiera teatrale me kukulla"

Neni 2 OBJEKTI I KONTRATËS

2.1 Sponsorizimin e "Projekteve artistike që Teatri i Kukullave do të realizojë gjatë vitit 2021/ Dy Premiera teatrale me kukulla" në shumën 1,000,000 (një milion) Lekë.

Neni 3



SHUMA E SPONSORIZIMIT

- 3.1 Është miratuar sponsorizimi në shumën 1,000,000 (një milion) Lekë, për "Projektet artistike që Teatri i Kukullave do të realizojë gjatë vitit 2021/ Dy Premiera teatrale me kukulla"

Neni 4

MËNYRA E PAGESËS

Pagesa do të bëhet pas kryerjes së shërbimit dhe paraqitjes së dokumentacionit përkatës dhe faturave që vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve për realizimin e "Projekteve artistike që Teatri i Kukullave do të realizojë gjatë vitit 2021/ Dy Premiera teatrale me kukulla"

Pagesa do të kryet në llogarinë e thesarit të "Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë" me numër llogarie 10900100 pranë Raiffeisen Bank.

Pagesa do të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dorëzimi i faturës.

Neni 5

DETYRIMET E PALËVE KONTRAKTUESE

- Sponsorizuesi

5.1 Kryen pagesën në shumën 1,000,000 (një milion) Lekë për realizimin e "Projekteve artistike që Teatri i Kukullave do të realizojë gjatë vitit 2021" bazuar dokumentacionin mbështetës, fatura që vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve.

- Përfituesi

5.2 Përfituesi detyrohet të paraqesë dokumentacionin justifikues të kryerjes së shpenzimeve sipas objektit të kësaj kontrate.

5.3 Përfituesi detyrohet që në të gjitha rastet në vijim kur ka nevojë për sponsorizim, t'i drejtohet së pari me kërkesë sponsorizuesit dhe vetëm në rast se kërkesa e tij nuk mbështetet nga sponsorizuesi, ka të drejtë t'i drejtohet sponsorizuesve të tjerë të mundshëm.

5.3.1 Përfituesi bie dakord që Sponsorizuesi ka të drejtën e ekskluzivitetit në industrinë të cilës i përket.

5.3.2 Përfituesi detyrohet të informojë paraprakisht Raiffeisen Invest sh.a për bashkësponsorët e tjerë dhe kontributin e tyre në projekt.

5.4 Përfituesi detyrohet të bëjë publike mbështetjen financiare të Raiffeisen Invest sh.a si më poshtë:

5.4.1 Vendosija e logos së Raiffeisen INVEST Sh.a në të gjitha materialet e marketingut si bileta, banera, fletëpalosje, katalogë që do të prodhohen për premierat dhe aktivitetet artistike në median vizive, atë të shkruar dhe në rrjetet sociale.

5.4.2 Vendosija e një baneri me logon e Raiffeisen INVEST Sh.a në këndin e posterave përpara Teatrit të Kukullave.

5.4.3 Vendosija e logos si dhe përmendja si sponsor gjeneral i Raiffeisen INVEST Sh.a në trailer të çdo premiere dhe në të gjitha spotet në rrjetet sociale.

5.4.4 Realizimi i një shfaqjeve për fëmijët në nevojë.



Neni 6

ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

- 6.1** Kjo Kontratë hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Palët dhe mund të ndryshohet vetëm me miratimin me shkrim nga të dy Palët.
- 6.2** Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 6.3** Në rast mosmarrëveshesh mes Palëve në lidhje me këtë Kontratë, Palët bien dakord të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Në rast se Palët nuk mund të arrijnë një marrëveshje brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e kërkesës me shkrim, atëherë çështja do t'i kalojë për kompetence Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 7


KODI I SJELLJES, PARIMET E INVESTIGIMIT DHE GDPR

- 7.1** Përfituesi mbart detyrimin që gjatë zbatimit të kësaj kontrate të aplikojë rregulla dhe standarde të njëjta apo të ngjashme, me ato të përcaktuara në Kodin e Etikës së Grupit Raiffeisen në Shqipëri, publikuar në adresën : www.rbinternational.com/codeofconduct Gjithashtu Tregtari detyrohet që të mos i përdorë pagesat që përfiton prej Bankës për qëllime apo aktivitete të paligjshme.
- 7.2** Me nënshkrimin e kësaj kontrate, secila nga palët i jep palës tjetër të drejtën për të kryer verifikime, me qëllim që të mbledhë informacionin e nevojshëm sa herë ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar se po kryhet një krim financiar (mashttrim, abuzim, korrupsion), që lidhet me zbatimin e kësaj kontrate. Verifikimet do të kryhen në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi, si dhe bazuar në parimet dhe standardet e palëve për kryerjen e procesit verifikues. Këto verifikime përfshijnë por nuk kufizohen në, mbledhjen e të dhënave dhe informacionit, si dhe pyetje që mund t'i bëhen punonjësve të palës tjetër, të cilët mund të kenë dijeni mbi faktet e ndodhura gjatë zbatimit të kësaj kontrate. (Parimet e Investigimit/verifikimit i bashkëngjiten kësaj kontrate si Aneksi Nr.2).
- 7.3** Palët bien dakord që kjo kontratë do të jetë në përputhje me kërkesat e sanksionuara në Ligjin nr. 9887 dt. 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Aktin Austriak të Mbrojtjes së të Dhënave Personale 2000 (DSG 2000), Rregulloren Europiane për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR) si edhe Aktin e ri Austriak të Mbrojtjes së të Dhënave Personale 2018 (DSG 2018) në fuqi nga data 25 Maj 2018. Palët bien dakord që dispozitat e kësaj kontrate dhe në veçanti detyrimet e Përfituesit do të interpretohen në atë mënyrë që të jenë në përputhje me aktet rregullative të sipërcituara. Në çdo rast, nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj kontrate nuk është plotësisht në përputhje me këto akte rregullative dhe në veçanti me GDPR, palët bien dakord të ndryshojnë këto dispozita në mënyrë që t'i përshtatin me këto kërkesa rregullative.

Neni 8

TË NDRYSHME

- 8.1** Për zbatimin dhe ndjekjen e kësaj kontrate ngarkohet Njësia e Marrëdhënieve me Publikun dhe Sponsorizimeve, pranë Raiffeisen Bank.
- 8.2** Përfituesi është në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në rregulloret e brendshme të Sponsorizimeve në lidhje me konfliktin e interesave dhe deklaron se asnjë punonjës i Raiffeisen Invest Sh.a, nuk zotëron interes privat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthorët me të.
- 8.3** Kjo kontratë u hartua në 2 (dy) kopje, nga një (1) për secilën palë dhe secila kopje ka të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtën vlerë ligjore.



SPONSORIZUESI
Raiffeisen INVEST SH.A
Administratore e Pergjithshme

Edlira Konini

(nënshkrimi)

Zv Administratore e Pergjithshme

Alketa Emin

(nënshkrimi)

PËRFITUESI
Qendra Kombëtare e Kulturës për
Fëmije-Teatri i Kukullave

Agim Bajko

(nënshkrimi)

ANEKS 2

Parimet e Investigimit

Ligjshmëria - Çdo investigim duhet të kryhet në përputhje me ligjet e aplikueshme dhe me rregulloret e brendshme të Grupit Raiffeisen, të cilat janë gjithashtu duhet të jenë në përputhje me ligjet e aplikueshme.

Supozimi i pafajësisë - Çdo investigim duhet të kryhet në përputhje me principin e supozimit të pafajësisë.

Mbrojtja e të dhënave personale - Personat që investigohen, nuk duhet të bëhen objekt i ndërhyrjeve arbitrare në jetën e tyre private, familjare, shtëpiake ose në korrespondencë dhe as t'u cënohet nderi dhe reputacioni.

Ne bis in idem - Investigimi nuk mund të kryhet kundër të njëjtit person për të njëjtin rast, përveç rasteve kur paraqiten prova dhe/ose fakte të reja.

Objektivitet dhe paanësi - Personat pjesëmarrës në investigim duhet të sillen me objektivitet dhe paanësi, duke mënjanuar faktorë diskriminues si kombësia, rraca, gjinia, orientimi seksual, mosha, aftësitë e kufizuara, feja dhe statusi civil. Përfundimet e investigimit duhet të jenë të mbështetura mbi prova që janë të përshtatshme, të besueshme dhe të plota.

Përpjesëtuueshmëria ose masa e duhur - Masa e investigimit duhet të jetë në proporcion me rëndësinë e rastit të dyshuar për mashtrim, në mënyrë që të ruhet të drejtat e personit që po investigohet dhe procesi të jetë sa më eficient.

Konfidencialiteti - Informacioni që mblidhet gjatë rrjedhës së investigimit duhet të trajtohet si konfidencial dhe të shpërndahet vetëm kur lind nevoja, në persona të autorizuar.

Profesionalizëm - Personat pjesëmarrës në procesin e investigimit duhet ta kryejnë investigimin me një nivel të lartë profesionalizmi dhe të përfshihen vetëm në ato investigime për të cilat kanë njohuritë, aftësitë dhe eksperiencën e duhur. Profesionalizmi i duhur kërkon korrektësi, analizim kritik, skepticizëm profesional dhe gjithashtu kompetencë në çështjen që është subjekt i investigimit.

Konflikt interesi - Personat pjesëmarrës në procesin e investigimit duhet të deklarojnë çdo konflikt interesi ekzistues ose të mundshëm (përfshirë, por jo vetëm, lidhje të drejtpërdrejta ose jo) me personat subjekt i investigimit. Konfliktet e interesit duhet të menaxhohen në përputhje me procedurat në fuqi.



